



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Malsijaj Company shpk" të datës 29.07.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "174 Prodhimi, furnizimi dhe vendosja e numrave të adresave për njësitë e banimit në Komunën e Prishtinës - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-5086-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Malsijaj Company shpk" të datës 29.07.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "174 Prodhimi, furnizimi dhe vendosja e numrave të adresave për njësitë e banimit në Komunën e Prishtinës - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-5086-1-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Malsijaj Company shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 29.07.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "174 Prodhimi, furnizimi dhe vendosja e numrave të adresave për njësitë e banimit në Komunën e Prishtinës - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-5086-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

- OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e ka plotësuar edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit, ku është specifikuar "3. Katalogu nga prodhuesi për pozicionet -3, 4 dhe 7", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "3. Kopja e autorizimit dhe kopja e katalogut për pozicionet - 3, 4 dhe 7".

Në lidhje me kërkesën e lartcekur OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar një katalog i cili është i kopjuar nga interneti, përkatësisht është marr direkt nga interneti dhe jo nga prodhuesi ashtu siç është kërkuar dhe specifikuar nga ana e AK-së.

Përderisa nuk është prezantuar katalogu sipas kërkesës së dosjes së tenderit, atëherë i njëjti është dashur të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të rekomandohet për kontratë, pasi që në këtë rast po favorizohet OE i rekomanduar për kontratë edhe përkundër faktit që i njëjti është i papërgjegjshëm.

- OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se i njëjti ka ofertuar me mostra të cilat nuk janë sipas kërkesave të dosjes së tenderit. Më poshtë po i shënojmë mangësitë e OE në mostra:

Mostrat e të njëjtit janë në kundërshtim me udhëzimin administrativ nr.15/2019 të datës 24.12.2019.

Tek specifikimet teknike të tabelave të adresave, neni 5 përmbajtja: Pika 1.5 TABELA "A" e lexuar në të dyja anët me emër të mostrës NËNË TEREZE, ndërsa sipas udhëzimit administrativ lartësia e shkronjës duhet të jetë 7 cm, ndërsa mostra e OE është prezantuar 7.3cm.

Tek lloji tjetër sipas udhëzimit administrativ shkronjat RR/UL duhet të jetë 6 cm, ndërsa tek mostra e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë pas matjeve në prani të zyrtarëve të prokurimit mostra figuron 5.6cm.

Trashësia e tabelës 60cm deri 100cm x gjerësia 25 cm, ndërsa trashësia kërkohet 1.5cm tabelë "A" me lexim në të dyja anët sipas udhëzimit administrativ pika 2.1 duhet të jetë 1.5cm, ndërsa në mostrën e OE figuron trashësia 1.8 cm dhe shkronjat calibër 2 mm, me fletë alumini të stampuara (apo Relief), ndërsa në mostër shkronjat janë të printuara në kundërshtim me udhëzimin administrativ nr.9 pika2.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe si i tillë i njëjti është i papërgjegjshëm, prandaj AK-ja është dashur ta eliminojë nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të rekomandohet për kontratë.

Gjithashtu grupi i OE TSR SHPK & IDK KONSTRUKSION SHPK, është i papërgjegjshëm edhe për faktet si në vijim:

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

ARSYETIM

Ju njoftojmë se oferta juaj është refuzuar, pasi është vlerësuar si e papërgjegjshme për arsyet në vijim:

Gjatë vlerësimit të mostrave për pozicionet 3, 4 dhe 7, janë konstatuar mospërputhje me kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit, si më poshtë:

Pozicioni 3: Sipas FDT-së, Shkronjat e emërtimit janë të realizuara në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit.

Gjatësia dhe gjerësia e tabelës janë gjithashtu në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara prej 60 - 100 cm në gjatësi.

Gjithashtu trashësia, megjithatë, është 1.6 cm, ndërsa në dosjen e tenderit është specifikuar që trashësia duhet të jetë 1 cm.

Pozicioni 4: Sipas FDT-së, Shkronjat e emërtimit janë të realizuara në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit.

Gjatësia dhe gjerësia e tabelës janë gjithashtu në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara prej 60 - 100 cm në gjatësi.

Gjithashtu trashësia, megjithatë, është 2 cm, ndërsa në dosjen e tenderit është specifikuar që trashësia duhet të jetë 1 cm.

Pozicioni 7: Sipas kërkesës të dosjes së tenderit, dimensionet e produktit për pozicionin 7 duhet të jenë 370 mm (gjerësi) x 370 mm (gjatësi) x 110 mm (lartësi).

Në mostrën e dorëzuar nga operatori ekonomik, janë vërejtur këto devijime:

Gjerësia: 370 mm (në rregull)

Gjatësia: 366 mm (më e vogël se sa kërkesa prej 370 mm)

Lartësia: 110 mm (më e vogël se sa kërkesa prej 110 mm).

Bazuar më sipër, mostra për pozicionin 7 nuk përmbush plotësisht kërkesat teknike të dosjes së tenderit, për shkak të devijimeve në gjatësi dhe lartësi.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që parashtruesi parashtruesi nuk ka prezantuar asnjë argument të vetëm për të kundërshtuar të gjeturat e komisionit vlerësues. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesin e rekomanduar është gjetur se përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP. Pavarësisht kësaj është gjetur se oferta e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT si dhe specifikat teknike të DT duke përfshirë edhe deklaratën për GOE, qarkullimin financiar, listën e kontratave, autorizimet dhe katalogjet. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 04.08.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.